

02 Nr. Br. 020/01-3402/24
07.02.2024
Dragash - Dragaš

RAPORTI I PUNES PER VITIN 2023 I DREJTORATIT PER EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Datë/a-Datum:	10.01.2024
Për-Za:	Kryetarin Bexhet Xheladini , Kuvendin e Komunës së Dragashit
Përgatitur nga:	Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Përmes-Preko :	E-mail dhe Arkivit
Nga-Od:	Qamil Kolloni, drejtor i Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
Tema:	Raporti i punës për vitin 2023 i Drejtoratit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim është i organizuar në këto njësi
punuese:

Nr.	Njësitë Punuese (Sektorët)	Veprimtaria
1	Zhvillim ekonomik	Promovimi dhe strategjia e zhvillimit ekonomik lokal
2	Buxhet dhe Financa	Parashikimi Buxhetit, Raportet financiare - transferet
3	Zyra e Tatimit në Pronë	Vlerësimi, faturimi, inkasimi i tatimit në pronë
4	Zyra për Regjistrimin e Bizneseve	Regjistrimi i Bizneseve
5	Njësia e Thesarit- regjistrimit te pasurisë komunale	Keshi dhe inventarizimi

Zyra për Zhvillim Ekonomik Janar-Dhjetor-2023

Zyra për zhvillim ekonomik konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja në vend, si promotorë e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulues për produktet vendore lokale.

Viti 2023, për zyrën e zhvillimit ekonomik të komunës së Dragashit ishte një vit sa i suksesshëm, aq edhe sfidues pasi që në pjesën e parë të vitit nuk e kemi pasur të punësuar Zyrтарin për Zhvillim Ekonomik, dhe drejtori për ekonomi financa dhe zhvillim ka organizuar pjesëmarrjen e Komunës dhe bizneseve komunale në panairin ndërkombëtar për turizëm dhe sport të mbajtur në sallën 1 të treti në Prishtinë me datën (26.04.2023-28.04.2023) e që ka pasur një efekt shumë pozitiv dhe kanë marrë pjesë katër biznese lokale.

Gjatë vitit 2023 i ka arritur objektivat duke dhënë kontribut në mbështetjen dhe rimëkëmbjen e biznesit vendas dhe investitorëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm, këshillimit, promovimit edhe me panairin e dytë të mbështetur nga komuna nëpërmjet shpalljes publike ku fituese ka qenë Shoqata Afariste "Sharri", ku ka bërë një punë të shkëlqyer duke organizuar panairin e dytë të Prodhimeve vendore Lokale "EXPO SHARRI 2023" në objektin e Shkollës Profesionale në 'Mejdan' të Shajnës ku u ekspozuan dhe promovuan produkte, biznese dhe veprimtari të shumta ekonomike që operojnë në Komunën e Dragashit.

Panairi i Produkteve Vendore Lokale 'EXPO SHARRI' u organizua nën patronat të kryetarit të Komunës së Dragashit, z.Bexhet Xheladini, dhe nga Shoqata e Afaristëve "SHARRI" me datën 04.08.2023.

Si pjesë e kësaj komune të Dragashit përkatësisht drejtoria për ekonomi financa dhe zhvillim ka dhënë një kontribut të madh pasi që ka mbështetur financiarisht edhe Panairin Ndërkombëtar të Agrobiznesit "AGROKOS" në Prishtinë ku pjesëmarrës kanë qenë katër agrobiznese lokale si dhe Komuna ka bërë promovimin e vendeve turistike e që drejtori për ekonomi financa dhe zhvillim së bashku me Kryetarin e komunës ka dhënë përkrahje morale në pjesëmarrjen e tyre. Ky panair është mbajtur me datën 19.10.2023 dhe 20.10.2023.

Njësia Punuese për Buxhet- Financa

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Qarkoreve Buxhetore 2024/1,2, ka marrë pjesë në përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Projekt-buxhetin për vitin 2024-2026, për periudhën në fjalë, duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Planin e Veprimit për rekomandimet e auditorit për Pasqyrat Financiare 2022 dhe raportet e progresit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e auditimit për vitin 2022.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka përgatitur Rregulloren për Tatimin në Pronë dhe ka raportuar në Asamblenë Komunale për raportet e realizimit të buxhetit.

Drejtorati për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka marrë pjesë nëpër dëgjime publike të organizuara në Asamblenë Komunale dhe nëpër fshatra për propozim-buxhetin e vitit 2024.

Ka përgatitur raportet mujore financiare, si dhe raportet tremujore financiare, për raportim në Asamblenë Komunale.

Në vazhdimësi kryen të gjitha pagesat dhe transaksionet për investime kapitale, mallra dhe shërbime, si dhe përcakton procedurat për ekzekutimin e pagesave.

Njësia e Tatimit në Pronë

Detyra kryesore e zyrës është që çdo vit të llogarisë dhe të faturojë pronarët dhe përdoruesit e pasurive të paluajtshme, shumën e taksave që duhet të paguajnë për një vit të caktuar, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur sa më shumë tatimin e llogaritur dhe të zbritur të pronës. Gjithashtu, të regjistrojë të gjitha objektet dhe pronat e reja, si dhe të verifikojë të paktën 1/5 e objekteve ekzistuese.

Për vitin 2023 kemi arritur këto rezultate:

Nr.rendor	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Shuma
1	Faturat e shpërndara	Cope	9435	-----
2	Ngarkesa për objekte	-----	-----	275, 980.13 €
3	Ngarkesa për toka	-----	-----	125, 825.66 €
4	Ngarkesa totale 2023	-----	-----	401,805.79 €
5	Te hyrat 2023	-----	-----	320.985,50 €
6	Te hyrat nga free balanc	-----	-----	324,437.87 €
7	Te hyrat per vitin 2022	-----	-----	295.238,46 €
8	Diferenca % 2022-2023			9 % Plus

Janë pranuar 140 ankesa të tatimpaguesve, prej të cilave **139** janë zgjidhur. Janë pranuar **129** ankesa dhe **10** janë refuzuar.

Njësia e Thesarit

Njësia e thesarit dhe e regjistrimit të pasurisë komunale raporton me këto të dhëna:

Ne arkën kryesore janë pranuar nga Inkasantët Shumat prej **57246 €**. Ku të njëjtat të hyra brenda ditës janë dorëzuar në bankë të ndara në baze të UNIREF-it për çdo pagës edhe janë bërë barazimet me zyrtarin e të hyrave.

Në të njëjtën periudhë kemi tërhequr **500 €** për pagesën e faktuarave të imta deri në **100 €**, dhe i kemi mbyllë në fund të vitit kalendarik.

Po ashtu në këtë vite kalendarik kemi tërhequr **98 avance** (Paradhënie) për udhëtime zyrtare në shumë prej **10096 €**.

Gjate kësaj periudhe kemi regjistruar Investimet Kapitale në sistemin e **SMFK** pasurinë mbi **1000 €**, dhe kemi regjistruar në sistemin **E PASURIA** edhe pasurin komunale nën **1000 €**.

Njësia - zyrtari përgjegjës në Qendrën Komunale për Regjistrimin e Biznesi

Zyra e Regjistrimit të Bizneseve në Komunën e Dragashit ka funksionuar me orare të plot duke ndihmuar Bizneset lokale në mbështetje dhe lehtësim në qasje dhe pranim të dokumenteve që ndërlidhen me këtë zyre, po ashtu bizneset kanë marrë shërbime dhe këshilla të nevojshme.

Duke u bazuar në statistikat që gjenden në sistem të ARBK – së figurojnë këto të dhëna:

Totali i Bizneseve të regjistruara në Komunën e Dragashit:

Nr.	Llojet e Bizneseve	Numri i Bizneseve
1	Biznese Individuale B.I	1737
2	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K	106
3	Ortakëri të përgjithshme	13
4	Koperativa Bujqësore	6
5	Ndërmarrje shoqërore N.SH	1

Numri i bizneseve të hapura në katër vitet e fundit:

Viti	Numri i bizneseve të reja
2020	60
2021	53
2022	54
2023	48
Totali	21

Aktivitetet që ofrohen nga bizneset e komunës së Dragashit janë si në vijim:

Nr.	Aktivitetet që shërbejnë më shumë	Numri Bizneseve
1	Tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara	125
2	Aktivitetet shërbyese të pijeve	90
3	Tregti me pakicë në dyqane ku mbizotëron ushqimi, pijet	80
4	Restorante dhe aktivitete shërbyese të ushqimit	75
5	Prodhim i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave	69
6	Ndërtimi objekteve banesore dhe jo banesore	41
7	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	36

Llojet e bizneseve sipas gjinisë në Komunën e Dragashit:

Nr.	Llojet e bizneseve	Meshkuj	Femra
1	Biznese Individuale B.I	674	74
2	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara SH.P.K	81	17
3	Ortakëri e Përgjithshme O.P	2	1
4	Numri total i bizneseve për meshkuj dhe femra	757	92

Mbajtja e kontratave të shfrytëzuesve të përkohshëm të objekteve komunale me karakter të përkohshëm dhe mbajtja e kontratave të pronës komunale me shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, në bazë të ankandeve të organizuara nga Komisioni Komunal për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, i themeluar nga Asambleja Komunale.

Qamil Kolloni

Drejtore i Drejtoriatit për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim - Komuna Dragash



Mob: 044/201-072

E-mail: Qamil.Kolloni@rks-gov.net

Web: kk.rks-gov.net/dragash/

Adresa: Sheshi Dëshmorëve 22000 Dragash